



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 21885 / Prot.,
11

Tiranë, më 27 / 10 / 2025

Lënda: Dërgohet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

Të gjitha Departamenteve

Të gjitha Drejtorive në DPD

Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm

Të gjitha Degëve Doganore

Ju bëjmë me dije se është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit Nr. 21885 Prot., datë 23 . 10 . 2025 ndërmjet ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve *“Mbi kontrollin e mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”*.

Merrni masat për njohje dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.

Strukturat teknike kompetente, të marrin masat për zbatimin e detyrimeve sipas përcaktimeve në marrëveshje.

Duke Ju falenderuar,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Nr. 21885 Prot., datë 23.10.2025

MINISTRIA E MBROJTJES

AUTORITETI I KONTROLLIT
SHTETËROR TË EKSPORTEVE

Nr. 1771 Prot., datë 23.10.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

“MBI
KONTROLLIN E MALLRAVE USHTARAKE DHE ARTIKUJVE E TEKNOLOGJIVE ME
PËRDORIM TË DYFISHTË”

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DHE

AUTORITETIT TË KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (në vijim DPD), e përfaqësuar nga Z. Genti Gazheli, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, me adresë “Rr. Industriale Tiranë-Durrës, Km. 1, kati 5, Qendra Pajton, Tiranë”

dhe

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (në vijim AKSHE), përfaqësuar nga Z. Andrea Shllaku në cilësinë e Kryetarit të Autoritetit, me adresë “Rr. Blloku i Ambasadave, Rr. "Skënderbej", Tiranë”.

Këtu, e në vijim të përmendura si, Palët,

MBËSHTETUR NË, ligjin nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr.46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave

ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre, nenin 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;

MEQENËSE:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Shqiptare synon garantimin e interesave fiskale, të sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe për këtë mbështetet në parimet strategjike, si:

- parimi i mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiare të vendit, përmes aplikimit të masave efektive për ndalimin e lëvizjes së mallrave të paligjshme, të kufizuara e të ndaluara, zhvillimit të mëtejshëm të një analize risku të efektshme për të kontribuar në luftën kundër terrorizmit e kriminalitetit, parandalimit, zbulimit, hetimit dhe procedimit për mashtrimet dhe shkeljet e legjislacionit doganor;
- parimi i bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella me institucionet e tjera shtetërore, përmes thellimit të bashkëpunimit ekzistues, koordinimit të aksioneve në mbrojtje të interesave financiare të Republikës së Shqipërisë, bashkërendimit të punës me agjencitë e tjera që operojnë në kufi;

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, ka detyrë funksionale kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë në funksion të sigurimit të interesave kombëtare të Republikës së Shqipërisë, të sigurisë dhe politikës së jashtme, kredibilitetit ndërkombëtar të saj dhe garantimit të respektimit të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në këtë fushë, duke ndërvepruar për këtë qëllim me organe/organizma brenda dhe jashtë vendit;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË:

- detyrimet ligjore të palëve që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e shtetit shqiptar, pa cënuar tregtinë ndërkombëtare,
- detyrimet specifike të parashikuara në ligjin nr.46/2018, ligjin nr.102/2014, të ndryshuar si dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe traktatet ku Shqipëria është palë;
- nevojën dhe detyrimin për bashkëpunim ndërinstitucional, pasi bashkëpunimi në interes të zbatimit të legjislacionit specifik të palëve është një faktor kyç për të siguruar informacionin e duhur dhe koordinimin e veprimeve për zbatimin korrekt të detyrimeve ligjore lidhur me kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë;

BIEN DAKORD,

të hartojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi, me përfaqësim në nivelin e titullarit të institucionit (Drejtor i Përgjithshëm /Kryetar), me përmbajtje, si vijon:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Marrëveshja ka si objekt lehtësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi dhe kryerjen e veprimtarive të bashkëpunimit e bashkërendimit ndërmjet palëve për kontrollin e mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë.
2. Kjo marrëveshje synon rritjen e bashkëpunimit mes palëve, duke u bazuar në një platformë të mirë komunikimi për shkëmbimin dhe koordinimin e informacionit, dhënien e asistencës për identifikimin dhe klasifikimin e mallrave gjatë hyrjes/daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë konform kërkesave të legjislacionit specifik të palëve.
3. Marrëveshja zbatohet për mallrat ushtarake dhe artikujt e teknologjitë me përdorim të dyfishtë që eksportohen, importohen apo transitojnë nëpër territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, lidhur me kontrollin shtetëror të lëvizjes së tyre si dhe kontrollin doganor të këtyre mallrave.
4. DPD ushtron kontroll doganor mbi të gjitha transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit doganor në fuqi.
5. AKSHE ka përgjegjësinë e inspektimit mbi të gjitha transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, sipas legjislacionit specifik në fuqi.
6. Bashkëpunimi do të realizohet vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë funksionimin e të dy palëve.
7. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të cenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palë që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit janë krijuar dhe funksionojnë.

Neni 2

Përkufizime

1. “Transferim ndërkombëtar i mallrave” është eksporti, eksporti i përkohshëm, importi, importi i përkohshëm, rieksperti, ndërmjetësimi, transiti ose transhipi nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë dhe çdo transferim tjetër jashtë apo brenda këtij territori, në të cilën janë përfshirë subjekte të ndryshme dhe mallrat e kontrolluara.

2. “Lista e mallrave të kontrolluara, objekt i kontrollit të transferimit ndërkombëtar” është listë që miratohet nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve në nenet 10, 11 dhe 48, të ligjit nr.46/2018, në përputhje me listat përkatëse të Bashkimit Evropian.
3. Përkufizimet e lartpërmendura dhe termat e tjerë të përdorura në këtë marrëveshje kanë kuptimin sipas përcaktimeve në Kodin Doganor dhe ligjin Nr.46/2018, të ndryshuar.

Neni 3 **Baza ligjore**

- Ligji nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,
- Ligji nr.46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar;
- Neni 24, i ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- VKM Nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”.

Neni 4 **Lista e mallrave dhe implementimi i kodeve tarifore**

1. Kontrolli i transferimeve ndërkombëtare shtrihet mbi të gjitha mallrat e kontrolluara, dhe mallrat e artikujt që nuk janë të përfshira në listën e mallrave të kontrolluara, të cilat janë objekt kontrolli i transferimit ndërkombëtar, sipas përcaktimeve të neneve 10 dhe 11 të ligjit nr.46/2018. Listat përkatëse të mallrave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve përditëson listat e mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, duke informuar menjëherë Autoritetet Doganore për të gjitha ndryshimet në të.
3. Palët angazhohen për implementimin brenda një kohe sa më të shkurtër të listës së harmonizuar të kodeve të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë dhe kodeve tarifore doganore sipas Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në sistemin informatik të doganës.

Neni 5 **Shtrirja e bashkëpunimit**

1. Palët ofrojnë ndihmë të ndërsjellë sipas kompetencave që zotërojnë në kryerjen e detyrave, si dhe në fusha të tjera, të cilat janë të lidhura me kontrollin e mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë.
2. Palët në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me objektin e punës bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

- a) shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin elektronik, duke respektuar detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave;
- b) vlerësimin dhe analizën e përbashkët të riskut;
- c) kryerjen e veprimeve dhe kontroleve të përbashkëta me kërkesë ose me iniciativën e secilës palë;
- ç) në harmonizimin e punës dhe përmirësimin e bashkëpunimit në të gjitha nivelet;
- d) përmirësimin e qarkullimit të mallrave strategjike në kufi;
- dh) bashkëpunimin me organet e tjera shtetërore dhe ato ndërkombëtare;
- e) dhënien e ekspertëve dhe të asistencës teknike;
- ë) realizimin e trajnimeve të përbashkëta;

II DETYRIMET E PALËVE DHE FORMAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 6

Veprime specifike dhe procedura gjatë hyrje - daljes së mallrave

1. AKSHE, dërgon pranë DPD në rrugë elektronike, kopje të:

- licencës së lëshuar dhe
- vendimit për pezullim, shfuqizim të licencës (që ka lëshuar më parë) për transferimin ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara, brenda 15 ditësh nga data e lëshimit të licencës/marrjes së vendimit.

2. Punonjësi doganor i vendos mallrat nën regjim doganor vetëm në rastet kur subjekti plotëson të gjithë dokumentacionin e duhur dhe paraqet licencën origjinale, si dhe kopje të noterizuar për praktikën doganore përkatëse.

3. Në rastet e eksportit, importit, transitit të mallrave, të cilat janë objekt i kësaj marrëveshje, kryhet kontrolli në doganë në zbatim të Ligjit nr.46/2018 "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake.

4. Në rastin kur importuesi apo agjenti doganor i paraqet punonjësit doganor një dokument për mallra, të cilat bëjnë pjesë në listat e mallrave ushtarake ose artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, punonjësi doganor kontrollon dhe sigurohet që të ketë dokumente të rregullta shoqëruese të ngarkesës, në mënyrë të vecante licencat përkatëse për transferim ndërkombëtar;

5. Në rast të ndonjë parregullsie në dokumentacion, në gjendjen fizike, në identifikimin e mallit, apo dyshimi të arsyetuar, punonjësi doganor duhet të kontaktojë personat e kontaktit në AKSHE, të përcaktuar si "persona kontakti".

6. Në rastin kur në pikat kufitare paraqitet një ngarkesë dhe punonjësi doganor ka një dyshim të arsyetuar se mallrat mund të bëjnë pjesë në listat e mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, atëherë mund të kërkojë nëpërmjet personave të kontaktit të konsultohet e mbështetet me ekspertizë nga AKSHE.

7. AKSHE asiston DPD, përmes pikave të kontaktit, menjëherë sapo i kërkohet ekspertiza dhe/apo prezenca fizike e ekspertëve të saj në doganë, për identifikimin dhe klasifikimin e mallrave të kontrolluara gjatë transferimit ndërkombëtar të tyre dhe për të përcaktuar nëse ato janë në përputhje me licencën e lëshuar ose kanë nevojë për licencë, me qëllim rritjen e efektshmërisë së kontroleve nga autoritetet doganore dhe reduktimin e kohës së qëndrimit të këtyre mallrave specifike në doganë.

8. Pas përfundimit të procedurës nga Zyra Doganore në Pikën e Kalimit Kufitar, mjetet e transportit vazhdojnë udhëtimin për në Zyrat doganore në brendësi të territorit;

9. DPD ka të drejtë të pezullojë procesin e transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara në territorin e Republikës së Shqipërisë nëse ka dyshime të arsyetuara (psh., ka informacion që ndikon në pezullimin/shfuqizimin e licencës, rrethanat kanë ndryshuar materialisht që nga koha e lëshimit të licencës) apo vërteton se janë shkelur dispozitat e Kodit Doganor dhe ligjit nr.46/2018. Në rastet e ngarkesave me mungesa në dokumentacion apo shkelje të tjera, çlirimi i mallit nuk mund të bëhet pa u plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi. Për këtë qëllim, DPD kërkon asistencën e AKSHE, e cila e mbështet me ekspertizën e vet në mënyrë që të merret vendimi përfundimtar.

10. Palët angazhohen në bashkëpunim të kryejnë kontrole të përbashkëta aposteriori ndaj operatorëve që kanë deklaruar mallra, objekt të kësaj marrëveshje, jo dual-use (jo me përdorim të dyfishtë).

11. DPD, njofton menjëherë AKSHE kur dyshon/konstaton se po kryhen veprime që konsiderohen shkelje, sipas përcaktimeve të Kodit Doganor dhe ligjit nr.46/2018.

Neni 7

Shkëmbimi i të dhënave/informacionit

1. Palët informojnë reciprokisht njëra tjetrën, *në kohë reale*, mbi bazën e kërkesës ose me iniciativë, mbi çdo të dhënë/informacion me të cilin vihen në dijeni gjatë punës së tyre, që mund të ndikojë në pengimin e lëvizjes së mallrave në dhe nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Palët shkëmbejnë informacion periodik tre muajor mbi të dhënat e importit/eksportit të kategorisë së mallrave me përdorim të dyfishtë dhe çdo të dhënë tjetër (p.sh. kompani, kategori mallrash, vende eksportuese apo origjine etj) që i shërbejnë këtij qëllimi.

3. Duke respektuar kushtet dhe nivelin e duhur të disponueshmërisë së të dhënave, shkëmbimi i të dhënave mund të kryhet me akses të drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, në të dhënat që administrohen nga Palët.

4. DPD, jep akses në Oracle ku do të gjenerohen raporte mbi transferimet ndërkombëtare të mallrave, objekt kontrolli nga AKSHE, për të dhënat si më poshtë:

- Nr. dhe datën e deklaratës doganore;
- Emrin e Subjektit dhe Nipt-in;
- Përshkrimin e produkteve dhe vlerën e faturës;
- Vendin eksportues dhe të origjinës;
- Subjektin importues/eksportues;
- Kodin e nomeklaturës.

5. Të dhënat për krijimin e përdoruesve do të dërgohen në DPD nga AKSHE në rrugë zyrtare, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Neni 8

Analiza e përbashkët e riskut

1. Palët bashkëpunojnë për kryerjen e analizave të përbashkëta të riskut, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr.46/2018 dhe në dispozitat e legjislacionit doganor, me objektiv minimizimin e rreziqeve në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, përfshirë edhe parandalimin e trafikut të tyre;

Neni 9

Koordinimi dhe raportimi

1. Palët planifikojnë dhe kryejnë veprime të përbashkëta në fushën e shkëmbimit të informacionit, analizës së riskut, kontrolleve të përbashkëta në Pikat e Kalimit Kufitar, trajnimit të personelit të tyre, si brenda vendit, ashtu dhe në aktivitete ndërkombëtare.

2. Me qëllim përmirësimit të efikasitetit të punës dhe për të rritur bashkëpunimin dhe marrëdhëniet në nivel qendror dhe lokal, palët koordinojnë midis tyre aktivitetet sipas kompetencave që zotërojnë.

3. Për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit palët përcaktojnë ekspertë, si persona kontakti dhe të gjitha komunikimet e palëve do të realizohen ndërmjet tyre, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe. Pikat e kontaktit caktohen dhe njoftohen nga palët përmes shkresave zyrtare menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

4. Pikat e kontaktit do të takohen në mënyrë periodike dhe do të diskutojnë dhe analizojnë rezultatet e bashkëpunimit, të dhënat e shkëmbimit, nevojën për masa përmirësuese dhe do të ndërmarrin veprime të koordinuara për të gjitha çështjet që janë me interes të përbashkët.

5. Takimet periodike do të kryhen *jo me pak se dy herë në vit*, pa përfshirë këtu takime të tjera për çështje të veçanta. Njoftimet për emrat dhe kontaktet e ekspertëve, datat e takimeve dhe tematikat përkatëse bëhen me shkresë zyrtare të secilës Palë.

6. Koordinatorët e bashkëpunimit paraqesin për palët raporte periodike mbi punën e tyre.

7. Palët në marrëveshje informojnë në mënyrë të ndërsjelltë për të gjitha çështjet e rëndësishme të implementimit të kësaj marrëveshje dhe inkurajojnë zbatimin e saj.

Neni 10

Asistenca teknike dhe trajnimet

1. Me qëllim përmirësimin e efikasitetit, operimit dhe racionalitetit në kryerjen e detyrave të secilës palë, si dhe të detyrave që janë me interes të përbashkët, palët do të ofrojnë ekspertët e nevojshëm dhe asistencë teknike. AKSHE bashkëpunon me DPD për dhënien e planeve/programeve dhe ekspertizës për kryerjen e kontrolleve në terren, në funksion të përmirësimit të njohurive teorike dhe praktike të personelit doganor lidhur me forcimin e sigurisë, përfshirë këtu mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

2. Në rast nevojë, si dhe me qëllim kryerjen e detyrave zyrtare, Palët do të ofrojnë pajisje teknike dhe të tjera për përdorim, nëse kjo nuk pengon kryerjen e rregullt të detyrave të Palëve.

3. Palët mund të prokurojnë pajisjet teknike për përdorimin e përbashkët.

4. Mbi bazën e kësaj marrëveshje palët shprehin vullnetin:

- a) Të organizojnë *pa pagesë* aktivitete formuese (trajnime, workshop, seminare) periodike në funksion të fushës që mbulojnë, me qëllim që të shpërndajnë njohuritë dhe ekspertizën e tyre, duke prezantuar praktikat më të mira për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes.
- b) Të njoftojnë në kohë njëra – tjetrën mbi iniciativat e organizimit të tavolinave të rrumbullakëta apo aktivitete të ndryshme, të cilat synojnë informimin dhe gjithëpërfshirjen.
- c) Të ofrojnë me apo pa kërkesë takime, me qëllim shkëmbim experience, informacioni apo trajnime specifike në kohë dhe natyrë apo vendndodhje.
- ç) Të angazhohen të propozojnë dhe/ose të aplikojnë në projekte të përbashkëta me fonde publike apo donatorësh.

Neni 11

Bashkëpunimi me organet e tjera

1. Palët, në kryerjen e detyrave të tyre dhe aktiviteteve të përbashkëta bashkëpunojnë edhe me organe të tjera të administratës shtetërore.

2. Palët veprojnë në mënyrë të koordinuar në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 12

Konfidencialiteti

1. Palët marrin përsipër ruajtjen e konfidencialitetit lidhur me çdo të dhënë apo informacion, me të cilat vihen në dijeni gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, duke marrë masat e nevojshme që mundësojnë sigurinë e të dhënave, në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi, veçanërisht për të dhënat personale, në mënyrë që të parandalojnë hyrjen, ndryshimin apo lëshimin e paautorizuar të të dhënave personale.
2. Përveç rasteve kur parashikohet me ligj ose siç mund të kërkohe në mënyrë strikte për të përmbushur detyrimet sipas kësaj marrëveshje, Palët nuk do ta përdorin, përhapin/zbulojnë ose ti bëjnë të njohur ndonjë palë të tretë ndonjë informacion/të dhënë të shkëmbyer në kuadër të kësaj marrëveshje.
3. Kjo klauzolë nuk zbatohet për informacionin që është bërë publik në mënyra të tjera ose është marrë nga një palë e tretë pa shkelur këtë klauzolë ose është kërkuar të bëhet e ditur nga ligji.
4. Palët nuk do të lejojnë përdorimin apo dhënien e çdo informacioni ose dokumenti konfidencial për qëllime të tjera nga ato të përmendura në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
5. Kërkesa për bashkëpunim dhe dhënie informacioni mund të mos plotësohet në këto situata:
 - a) kur informacioni i kërkuar është në kundërshtim me ndonjë ligj apo akt që rregullon ruajtjen e konfidencialitetit ose sekretit tregtar apo profesional;
 - b) kur kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjet specifike dhe në këtë marrëveshje.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Ndryshimet në marrëveshje

1. Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë dispozitë e saj nuk është në tejkalim ose kundërshtim të akteve përkatëse ligjore e nënligjore, mbi të cilat palët ushtrojnë veprimtarinë e tyre.
2. Palët, kur gjykohet e arsyeshme dhe duke rënë dakord paraprakisht midis tyre, mund të ndryshojnë ose shtojnë dispozita të kësaj marrëveshje si dhe Aneksë për forma specifike të bashkëpunimit dhe sidomos për shkëmbimin e të dhënave.
3. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje është i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet apo paqartësitë në zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhen me mirëkuptim nga Palëve. Në rast mosplotësimi të detyrimeve nga Palët, secila Palë duhet të informojë Palën tjetër. Në rast të mosdakordësisë, problematika u parashtrohet ministrave respektivë për diskutim e zgjidhje.

Neni 15
Publikimi

1. Kjo marrëveshje nuk publikohet në Fletore Zyrtare. Ajo është dokument në përdorim të strukturave të të dy Palëve, në nivelet e përcaktuara respektivisht nga drejtuesit më të lartë;

2. Kjo marrëveshje mund tu bëhet e njohur partnerëve ndërkombëtarë të Palëve, përfshirë programet e asistencës teknike dhe ato të zhvillimit.

Neni 16
Shfuqizime, afati dhe hyrja në fuqi

1. Memorandumi i bashkëpunimit “Mbi kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë” i nënshkruar nga DPD dhe AKSHE me nr.19550 Prot., i DPD datë 5.12.2011, shfuqizohet.

2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pa kufizim kohe.

3. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e Palëve.

Nënshkruar në, më 2025, në katër kopje autentike, nga dy për secilën Palë.

PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME

TË DOGANAVE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli



PËR AUTORITETIN E KONTROLLIT

SHTETËROR TË EKSPORTEVE

KRYETAR I AUTORITETIT

